



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 23, datë 23.03.2020

**“PËR  
AMENDIMIN E KONTRATËS ME OPERATORIN E TRANSPORTIT PUBLIK  
SHOQËRINË “SHEGA TRANS SHA”, NË KUADËR TË MARRJEVE TË MASAVE  
GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA  
COVID-19, PËR OFRIMIN E KËTIJ SHËRBIMI NË FUNKSION TË PERSONELIT  
DHE STAFIT MJEKËSOR”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 5/1 të Aktit normativ nr. 3, datë 16.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, të ndryshuar, të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, nenit 13, nenit 14, nenit 15, nenit 17 dhe nenit 19 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

- Miratimin e amendimit të kontratës nr.9869, datë 15.03.2017 të diktuar nga situata emergjente me operatorin e transportit publik shoqërinë “Shega Trans SHA”, për Linjën nr.15 Kombinat – Kinostudio, në kuadër të marrjeve të masave gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, për ofrimin e këtij shërbimi vetëm në funksion të personelit dhe stafit mjekësor, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Itenerari dhe stacionet janë sipas vendimit nr.39/2016 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, menyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të

autobuzeve të shërbimit në këto linja”, të ndryshuar, duke shtuar në këtë itinerar edhe stacionin pas Muzeut Kombëtar në kthim.

- Miratimin e amendimit të kontratës për Linjën nr.8 “Ish Stacioni i Trenit – Qendër – Sauk i Ri/ Sauk i Vjetër/ Sanatorium – Teg” vetëm për degëzimin e senatoriumit me pikë nisje të stacionit pas Muzeut Kombëtar, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Shërbimi i transportit publik qytetas për linjën e parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, do të ofrohet nga shoqëria “Shega Trans” sha, për gjithë kohëzgjatjen e periudhës së shkaktuar nga infeksioni Covid 19 dhe deri sa funksionimi normal i transportit publik do të qëndroj i pezulluar.
- Itenerari dhe stacionet do jenë pjesërisht sipas vendimit nr.39/2016 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e linjave të transportit qytetas dhe rrethqytetas të udhetarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobuzëve të shërbimit në këto linja”, të ndryshuar, me itinerar vajtje – ardhje vetëm për degëzimin e senatoriumit me pikë nisje të stacioni pas Muzeut Kombëtar.
- Shpenzimet mbulohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2020 të miratuara për këtë qëllim.
- Amendimi kontratës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga zëvendëskryetari i bashkisë në cilësinë e autoritetit kontraktor të Bashkisë Tiranë.
- Ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI  
  
TONI GOGU

